

0 RQV RUP LL  
6VMDMUNW  
. RPE- VUHS- U  
%DUJ LQ  
\* NQRUH

!



# Monitorim i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore

Bashkia Fier

VITI 2020

Ky raport është hartuar nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGJZH), në kuadrin e projektit "Sigurimi i ekspertizës teknike për qeverinë dhe OSHC-të për zhvillimin, buxhetimin, zbatimin dhe monitorimin e masave për adresimin e dhunës ndaj grave në Strategjinë e re për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit", Projekti zbatohet në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara "Për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave", financuar nga Qeveria e Suedisë dhe që po zbatohet nga UNDP, UN Women dhe UNFPA, në bashkëpunim me Qeverinë e Shqipërisë

Përmbajtja e këtij raporti është vetëm përgjegjësi e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim dhe nuk reflekton opinionin e SIDA, UNDP, UNFPA dhe UN Women.

## Tabela e Përmbajtjes

<b>TABELA E PËRMBAJTJES</b> .....	<b>3</b>
<b>SHKURTIME</b> .....	<b>4</b>
<b>HYRJE</b> .....	<b>5</b>
RRETH ORGANIZATAVE ZBATUESE .....	5
PËRSE MONITORIM I SKBGJ-SË NGA OSHC-TË? .....	6
METODOLOGJIA.....	6
<b>MONITORIMI I QËLLIMIT TË III-TË STRATEGJIK TË STRATEGJISË KOMBËTARE DHE PLANIT TË VEPRIMIT PËR BARAZI GJINORE 2016-2020</b> .....	<b>8</b>
<b>GJETJET KRYESORE</b> .....	<b>8</b>
TË DHËNA NGA MEKANIZMI I KOORDINUAR I REFERIMIT - BASHKIA FIER.....	10
TË DHËNA NGA DREJTORIA VENDORE E POLICISË PËR BASHKINË FIER.....	11
TË DHËNA NGA GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR, BASHKIA FIER .....	13
TË DHËNA NGA PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR, BASHKIA FIER.....	14
<b>REZULTATET E MONITORIMIT – VITI 2020</b> .....	<b>14</b>
OBJEKTIVI 3.1 NDËRGJEGJËSIMI I SHOQËRISË PËR TË MOS PRANUAR DHE PËR TË MOS TOLERUAR USHTRIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE. ....	14
OBJEKTIVI 3.2: FUQIZIMI I MEKANIZMAVE TË REFERIMIT SI DHE SHTIMI/PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE TË SPECIALIZUARA PËR MBROJTJEN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE. ....	17
OBJEKTIVI 3.3: NDËSHKIMI I DHUNUESVE DHE DHËNIA E MUNDËSISË PËR REHABILITIMIN E TYRE, PËRMES PROGRAMEVE TË SPECIALIZUARA. ....	22
KONKLUZIONE TË RËNDËSISHME.....	24
<i>Rekomandime kryesore</i> .....	25

## Shkurtime

ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BE	Bashkimi Evropian
BGj	Barazia Gjinore
DhBGj	Dhunë me bazë Gjinore
DhF	Dhunë në Familje
GTN	Grupi Teknik Ndërdisciplinor
INSTAT	Instituti i Statistikave në Shqipëri
KONVENTA CEDAW	Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
KONVENTA E STAMBOLLIT	Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
KD	Komiteti Drejtues
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
MShMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NBGj	Nëpunës i Barazisë Gjinore
NjVQV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
OShC	Organizatë e Shoqërisë Civile
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit
QAGjZh	Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim
QZhK "Sot për të Ardhmen"	Qendra për Zhvillim Komunitar "Sot për të Ardhmen"
REVALB	Sistemi elektronik (on-line) i regjistrimit të rasteve të dhunës në Shqipëri
RrFGSh	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri
SKBGj	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore
ShGPS	Shoqata e Grave me Probleme Sociale, Durrës
UM	Urdhër Mbrojtjeje
UMM	Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UN WOMEN	Entitet i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

## Hyrje

Ky raport u hartua në kuadër të Projektit "Sigurimi i ekspertizës teknike për qeverinë dhe OSHC-të për zhvillimin, buxhetimin, zbatimin dhe monitorimin e masave për adresimin e dhunës ndaj grave në Strategjinë e re për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit", në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara "Për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave", të financuar nga Qeveria e Suedia i cili po zbatohet nga UNDP, UN Women dhe UNFPA në partneritet me Qeverinë shqiptare. Në Shqipëri projekti u zbatua nga Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim", në bashkëpunim me disa organizata të tjera joqeveritare. Bashkitë e përfshira në monitorim ishin bashkitë e Lezhës, Kamzës, Fierit, Sarandës dhe Pogradecit.

Qëllimi i projektit është monitorimi i i detyrimeve ndërkombëtare dhe kombëtare të Shqipërisë për eliminimin e dhunës ndaj grave dhe të gjitha formave të diskriminimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare, ndërsa rezultati i pritur në terma afatgjatë është ulja e fenomenit të dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe të gjitha formave të tjera të diskriminimit në Shqipëri. Proçesi monitorues i SKBGj dhe PKV 2016-2020 për bashkitë e lartpërmenduar u zhvillua përgjatë periudhës Nëntor 2020 - Maj 2021. Aktivitetet në nivel qendror u monitoruan nga QAGjZh dhe në nivel lokal nga organizatat lokale, përmes mbledhjes së të dhënave zyrtare lidhur me zbatimin e Qëllimit Strategjik 3, të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit 2016 – 2020.<sup>1</sup>

### **Gjatë zbatimit të projektit u arrit që:**

1. Të realizohej monitorimi i punës për t'i dhënë fund dhunës kundër grave dhe vajzave nëpërmjet mekanizmave të referimit si një mjet i cili identifikon arritjet dhe sfidat apo boshllëqet ekzistuese.
2. Organizatat partnere në projekt të rrisin kapacitetet për të monitoruar zbatimin e Objektivit të 3-të të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2016-2020;
3. U përdorën rezultatet nga monitorimi i fazës së parë për të kontribuar në përpilimin dhe implementimin e Strategjisë së re të Barazisë Gjinore duke filluar nga viti 2021.
4. U realizua procesi i promovimit dhe advokimit, për zbatimin e objektivit të 3-të të SKBGj 2016-2020, duke përdorur gjetjet dhe rekomandimet e proceseve monitoruese.

Ky projekt, e nisi punën me organizimin e seancave informuese me përfaqësuesit e organizatave partnere në 5 Bashkitë nën monitorim, bazuar në udhëzuesin për monitorimin e Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020, të realizuar nga GADC, në Nëntor 2019 dhe të rishikuar në fillim të vitit 2020. Përveç manualit, u hartuan skedat monitoruese bazuar në indikatorët për monitorimin e zbatimit të Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020, të cilat u përdorën gjatë procesit të monitorimit.

### ***Rreth organizatave zbatuese***

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGjZh) është një organizatë jo-fitimprurëse shqiptare që vepron dhe punon në të gjithë Shqipërinë për fuqizimin e grave dhe për të krijuar një të ardhme të barabartë dhe të drejtë për vajzat dhe gratë me të ardhura të ulëta në të gjithë Shqipërinë, duke u përpjekur për t'i nxjerrë nga varfëria dhe përjashtimi. Për të mbrojtur të drejtat e grave dhe për t'i fuqizuar ato, QAGjZh ngre fonde kombëtare dhe ndërkombëtare.

Fushat kryesore të ekspertizës së QAGjZh-së janë:

---

<sup>1</sup> <https://www.un.org.al/sites/default/files/SKGBJ-AL-web.pdf>

- Promovimi i paqes dhe përpjekjet për t'i dhënë fund dhunës me bazë gjinore;
- Garantimi i fuqizimit ekonomik të grave;
- Sipërmarrjet e grave;
- Fuqizimi i qytetarëve për të monitoruar agjendën gjinore lokale;
- Rritja e përfaqësimit të grave në politikë dhe vendimmarrje;
- Përmirësimi i të drejtave të grave në zona rurale.

Gjatë procesit të monitorimit të bashkive Fier, Lezhë, Pogradec, Sarandë dhe Kamëz, QAGJZh bashkëpunoi me disa organizata të tjera të cilat veprojnë në territorin e bashkive nën monitorim si: Qendra Rinore Vlorë, Epoka e Re Fier, Tjetër Vizion Elbasan dhe Shoqata për Integrimin e Zonave Informale Kamëz.

### ***Përse monitorim i SKBGj-së nga OShC-të?***

Përgjegjshmëria në qeverisje është një element i rëndësishëm që përcakton marrëdhëniet midis atyre që ushtrojnë fuqinë e pushtetit dhe atyre në emër të të cilëve ushtrohet kjo fuqi. Në sistemet demokratike, fuqizimi i sistemeve të transparencës dhe përgjegjshmërisë është prioritet i vazhdueshëm, që sigurohet përmes mekanizmave të ndërtuar, që përmirësohen vazhdimisht e që garantojnë pjesëmarrjen aktive në vendimmarrjen publike të shoqërisë civile, OShC-ve apo vetë përfaqësuesve të komuniteteve lokale. Këto mekanizma forcojnë proceset demokratike, sigurojnë zhvillim efektiv përmes dhënies së shërbimeve efektive, lehtësojnë procesin e mirëqeverisjes dhe fuqizojnë grupet më vulnerabël të komuniteteve, siç janë vajzat e gratë viktimat të dhunës në familje.

Ndërkohë që ligjet dhe strategjitë kombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e vajzave e grave dhe dhunën në familje/ me bazë gjinore janë hartuar me kontributin e vyer e të pakursyer të OShC-ve të grave, deri tani kjo rutinë nuk është shoqëruar me procese monitoruese e vlerësuese nga vetë OShC-të. Organizatat e grave në Shqipëri kanë të gjitha kapacitetet e nevojshme për të monitoruar dhe vlerësuar strategjitë dhe planet e veprimit në fushën që ato punojnë çdo ditë. Mbi të gjitha, ato për shumë vite kanë luajtur një rol vendimtar në adresimin e dhunës ndaj grave nëpërmjet ofrimit të shërbimeve, rritjes së ndërgjegjësimit, ngritjes së kapaciteteve, lobimit dhe advokimit, duke u bërë kështu aktorë kyç në nivel vendor e kombëtar.

OShC-të janë shumë të interesuara që të monitorojnë strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit, në mënyrë që të ketë një të kuptuar më të mirë të asaj që qeveria po bën në këtë drejtim. Qëllimi përfundimtar është, zbatimi i një procesi monitorimi të paanshëm që do të sigurojë një zbatim më të mirë të hapave të ardhshëm që do ndërmerren për reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe avancimin e barazisë gjinore në shoqëri. Vlen të theksohet se, Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS), e ka mirëpritur këtë nismë dhe ka theksuar se ky monitorim nga shoqëria civile do të shërbejë për të informuar edhe procesin e monitorimit të brendshëm të SKBGj 2016-2020 nga institucionet përgjegjëse.

### ***Metodologjia***

Për të kryer monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2016-2020 dhe Planit të Veprimit, u ndoq një qasje e dyfishtë metodologjike në mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore. Një eksperte lokale u përzgjedh për çdo Bashki të targetuar, me qëllim ndjekjen e punës së Bashkisë përkatëse dhe mbledhjen e të dhënave për periudhën Janar – Dhjetor 2019. Procesi i mbledhjes së të dhënave është kryer si më poshtë vijon:

- Mbledhja e të dhënave përmes takimeve informuese me zyrtarë lokal e publikë. Faza e parë ishte kontakti me kryetarët e Bashkive të targetuara, për njoftimin e tyre mbi iniciativën e monitorimit. Më pas, monitorueset kontaktuan përmes një formati të njëjësuar, koordinatorin vendor të dhunës pranë Bashkisë dhe kurdo që ishte e mundur me drejtorinë e shërbimeve sociale, drejtorinë e shëndetit, organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në territorin e bashkisë, zyrtarët e gjykatave të rrethit, komunitetet fetare, mediat, organizatat ndërkombëtare dhe aktorë të tjerë të përfshirë në luftën kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Qëllimi i këtyre takimeve ishte vendosja e kontaktit që më pas u ndoq me kërkesa për informacion, të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera mbi punën e kryer nga Bashkia dhe institucione të tjera, për adresimin e objektivit të tretë të SKBGj për eliminimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Monitorueset gjithashtu kanë ndjekur takimet e zhvilluara në kuadër të mekanizmit të referimit në Bashki dhe kanë raportuar mbi përmbajtjen e tyre dhe vendimet e marra.
- Mbledhja e të dhënave përmes burimeve zyrtare e statistikore. Përmes të drejtës për informim, monitorueset kanë kërkuar të gjithë dokumentet mbështetëse të punës së bashkisë në kuadër të luftës kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Specifikisht:
  - Janë mbledhur minutat mbi takimet e mekanizmit të referimit për çdo bashki, që kanë plotësuar informacionet e ndara me monitorueset përmes intervistave.
  - Janë marrë të dhëna statistikore mbi prevalencën e dhunës në familje nga gjykatat, shërbimi i provës, bashkia, policia, shërbimi social dhe INSTAT.
  - Është analizuar buxheti vjetor i bashkisë për të identifikuar burimet financiare të alokuara për zbatimin e SKBGj në luftën kundër dhunës në familje.
  - Janë mbledhur materiale mbështetëse për aktivitetet ndërgjegjësuese të zhvilluara nga ana e bashkisë për përmbushjen e objektivit 3.1.

Raporti i monitorimit ndjek strukturën e objektivave specifike të SKBGj sa i përket dhunës me bazë gjinore si edhe aktivitetet specifike të planit të veprimit. Për këtë është hartuar një skedë monitoruese e cila është plotësuar në vijimësi nga monitorueset përmes informacionit të akumuluar përgjatë periudhës monitoruese.

Bazuar tek skeda monitoruese është bërë vlerësim i përmbushjes së angazhimeve të bashkive të targetuara nën objektivin e tretë të SKBGj duke identifikuar nga njëra anë praktikat pozitive prej të cilave mund të përfitojnë edhe bashki të tjera dhe nga ana tjetër sfidat dhe mangësitë me të cilat përballen bashkitë, për të identifikuar mundësitë për përmirësim në periudhën e mbetur të planit të veprimit të SKBGj.

Për të kryer monitorimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore janë përdorur edhe të dhënat e sistemit REVALB. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me mbështetjen e UNDP ka hartuar dhe miratuar bazën e nevojshme ligjore për funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Bashkërendimit të Punës dhe Referimit të rasteve të dhunës në familje në mënyrë që të parandalohen, raportohen dhe trajtohen me efektivitet rastet e dhunës në familje.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 334, dt 17.02.2011 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij" përcakton midis të tjerave dhe detyrimet konkrete të institucioneve shtetërore përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave, raportimin dhe referimin e rasteve të dhunës në familje. Sistemi online në lidhje me statistikën për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje në nivel bashkie është lançuar në vitin 2014. Ky sistem online regjistron çdo rast dhune, monitoron si po ecën referimi i rastit dhe ku ka ngecur ai, duke siguruar që t'i shkojë deri në fund çdo rasti të raportuar të dhunës në marrëdhëniet familjare. Sistemi online është i sigurt dhe respekton fshehtësinë e të



mbijetuarave të dhunës. Ai përdoret nga një numër i kufizuar i nëpunësve vendorë dhe qendrorë, të cilët janë trajnuar posaçërisht për përgjigjen ndaj dhunës në familje, fshehtësinë e të dhënave të së mbijetuarës dhe për përdorimin e sistemit. Ky sistem aksesohet nga të gjitha bashkitë në nivel lokal dhe MShMS në nivel qendror në adresën [www.revalb.org](http://www.revalb.org)

Mbi bazën e të dhënave të hedhura, sistemi prodhon raporte interaktive dhe të mundshme për t'u printuar në kohë reale të cilat kontribuojnë në: hartimin e politikave; matjen e efektivitetit të Grupeve Teknike Ndërdisciplinore (GTN) të ngritura në nivel lokal; përmirësimin e të dhënave statistikore të rasteve të dhunës në familje në nivel lokal; në marrjen e masave për mirë-funksionimin e mekanizmit referues në të gjitha njësitë vendore; Kryerjen e analizave statistikore, për të identifikuar probleme si dhe fusha ku ka nevojë për ndërhyrje; për të shmangur të gjitha dyshimet për të dhënat e pavërteta ose shifrat e gabuara, që çojnë në rritjen e besimit dhe përmirësimin e shkallës së bashkëpunimit midis aktorëve dhe të atyre që përfitojnë prej saj.

### **Monitorimi i Qëllimit të III-të Strategjik të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020**

#### ***Informacioni më poshtë i referohet gjetjeve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë gjatë vitit 2020.***

#### **Gjetjet kryesore**

- Për periudhën Janar - Dhjetor 2020, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier janë regjistruar 197 çështje për "Dhuna në familje" neni 130.
- Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka regjistruar 152 raste të dhunës ndaj gruas dhe në 45 raste të dhunuarit kanë qenë burra.
- Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2020 janë regjistruar 129 kërkesa për Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtje dhe 68 kërkesa për Urdhër Mbrojtje. Janë pranuar 148 kërkesa, janë rrëzuar 26 prej tyre, ndërsa 23 çështje janë pushuar.
- Në 95 raste i/e dhunuari/a ka qenë i/e papunë, në 30 raste ka qenë në pension, në 35 raste i/e punësuar në sektorin privat, në 19 raste i/e vetëpunësuar, në 15 raste në sektorin publik dhe në 2 raste nxënës shkolle.
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2020, në Zyrë e Shërbimit të Provës Fier, janë regjistruar 6 urdhëra ekzekutimi për të rritur, dënuar sipas veprës penale të parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal, 1 (një) prej të cilëve ka qenë ndaj një gruaje;
- Për periudhën Janar – Dhjetor 2020, në Zyrë e Shërbimit të Provës Fier, janë regjistruar 7 urdhëra ekzekutimi për të rritur, dënuar sipas veprës penale të parashikuar nga neni 130/a/4 i Kodit Penal, një prej të cilëve ka qenë ndaj një gruaje;
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2020, në Zyrë e Shërbimit të Provës Fier është regjistruar 1 urdhër ekzekutimi për të mitur, dënuar sipas veprës penale të parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal;
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2020, në Zyrë e Shërbimit të Provës Fier janë regjistruar 2 kërkesa për Raporte Vlerësimi për të Miturit, akuzuar sipas nenit 130/a/1, nga prokuroritë, 8 (kërkesa për Raporte në fazë hetimi, akuzuar sipas nenit 130/a//1, si dhe 4 kërkesa për Raporte në fazë hetimi akuzuar sipas nenit 130/a/4 dërguar nga Prokuroria Fier.

- Gjatë vitit 2020 vazhdon të jetë në fuqi marrëveshja që ka nënshkruar Bashkia Fier me Ministrinë e Drejtësisë në vitin 2019, për të përdorur qendrën multifunksionale „Horizont“ për të miturit në konflikt me ligjin.
- Bashkia Fier nuk ka një buxhet specifik vetëm për shërbimet ndaj viktimave të dhunës në familje. Të gjitha aktivitetet dhe materialet ndërgjegjësuese e lobuese mundësohen dhe prodhohen me buxhetin e Drejtorisë së Shërbimit Social, ku përfshihet dhe sektori i dhunës në familje. Buxheti për Drejtorinë e Shërbimit Social ka një vlerë prej 5 mln lekë, ku përfshihen të gjitha shërbimet sociale që ofron Bashkia Fier. Nuk ka një zë specifik vetëm për Mekanizmin e Koordinuar të Referimit. Nga ky buxhet mund të përdoret një pjesë edhe për Mekanizmin e Koordinuar të Referimit, në varësi të nevojave/aktiviteteve.
- Për vitin 2020 nga buxheti i Bashkisë Fier për shërbimet për viktimat e dhunës në familje, buxheti ka përfshirë vetëm pagën e koordinatorit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit që shkon në 708 000 lekë.
- Mekanizmi i Referimit në Bashkinë Fier, ka realizuar 5 mbledhje Ekipi Teknik Ndërdisciplinar gjatë vitit 2020 dhe asnjë mbledhje të Komitetit Drejtues.
- Takimet e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit vazhdojnë të organizohen bashkërisht me ato të Grupit Teknik Ndërdisciplinar, duke qenë se pjesa më e madhe e anëtarëve janë të njëjtë.
- Koordinator i Mekanizmit të Koordinuar të Referimit, znj. Natasha Sollaku ka ushtruar në mënyrë të plotë funksionet e veta përgjatë periudhës Janar - Dhjetor 2020.
- Në kuadër të ndryshimeve në Ligjin Nr. 9669 datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” aktorët e mekanizmit të referimit si të Bashkisë Fier, po ashtu dhe të Njësive Administrative janë trajnuar në Workshopin me temë “Informimi dhe diskutime mbi ligjin Nr. 47/2018 (ndryshimet në Ligjin e Dhunës) dhe sfidat në zbatimin e tij”.
- Mekanizmi i Referimit ka zhvilluar në bashkëpunim edhe me anëtarët e saj – institucione vendore dhe Organizata Jofitimprurëse të ndryshme 10 aktivitete.
- Protokolli i menaxhimit i është dërguar të gjithë institucioneve anëtare të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit dhe është aprovuar nga të gjithë në muajin prill.
- Për periudhën Janar – Dhjetor 2020, Mekanizmi i Koordinuar i Referimit - Bashkia Fier ka regjistruar gjithsej 94 raste dhune në familje.
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2020, janë evidentuar 233 raste dhune në familje, 57 prej të cilave janë për veprën penale neni 130/a.
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2020, 249 ishte numri i të dëmtuarve, ku 167 prej të cilëve ishin gra dhe vajza.
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2020, Drejtoria Vendore e Policisë Fier regjistron 31 autorë të arrestuar, 8 të ndaluar, 21 në gjendje të lirë dhe 2 në kërkim.
- Për periudhën janar - dhjetor 2020, Drejtoria Vendore e Policisë Fier ka referuar 162 raste kërkesë padi për Urdhër Mbrojtjeje.
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2020, nga Zyra e Përmbartimit Fier janë ekzekutuar 18 tituj ekzekutiv, Urdhër Mbrojtjeje për veprën penale neni 130/a, nga të cilat 16 kanë qenë për dhunën e burrit ndaj gruas dhe 2 kanë qenë për dhunën e fëmijëve ndaj prindërve.
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2020, në Prokurorinë së Rrethit Gjyqësor Fier janë regjistruar 84 procedime për veprën penale "Dhuna në familje", nga të cilat 42 i përkasin nenit 130/a/1 dhe 40 neni 130/a/4 të Kodit Penal.
- Gjatë vitit 2020 janë punësuar 2 gra kryefamiljare me Urdhër Mbrojtjeje në sektorin privat. Të dy të mbijetuarat trajtohen edhe me bonus qeraje.

## *Të dhëna nga Mekanizmi i Koordinuar i Referimit - Bashkia Fier*

Për Bashkinë Fier koordinatore vendore e sektorit të Shërbimit Social, Njësia për BGJ & DHF, NGJ & KV është Natasha Doko Sollaku (Kohë të plotë). MKR në Bashkinë Fier është ngritur në vitin 2012, në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit dhe së fundmi në bazë të Protokollit të Menaxhimit të Rasteve të Dhunës në Familje. Nga monitorimi i zbatimit të strategjisë në nivel lokal, Planit të Veprimit Lokal, rezulton se rolin kryesor në fushatat ndërgjegjësuere në Bashkinë Fier e luajnë kryesisht Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC). Mungon një buxhet i dedikuar për fushata ndërgjegjësuere nga Bashkia Fier, por ky zë (fushatat ndërgjegjësuere kundër dhunës në familje dhe me bazë gjinore), çdo vit realizohen me fondin e përcaktuar për Drejtorinë e Shërbimit në Bashkinë Fier, brenda së cilës përfshihet si zë shpenzimi për aktivitete.

Mekanizmi i Referimit kundër dhunës në Familje pranë Bashkisë Fier, për periudhën Janar – Dhjetor 2020 ka referuar 94 raste. Për shkak të situatës pandemike, MKR ka asistuar në plotësimin e një numri shumë herë më të ulët të UM<sup>ve</sup> dhe UMM<sup>ve</sup>, që shkon deri në 23.

**Tabela 1. Raste të suksesshme të trajtuara nga Mekanizmi i Referimit, Bashkia Fier**

<b>Rasti</b>	<b>Trajtimi</b>
<b><i>J.G.71 vjec, në gjendje të mirë shëndetësore dhe fizike jetonte në Greqi në familjen e vajzës së saj. Kohët e fundit kishte debate dhe dhunë psikologjike nga dhëndri i saj. Ky i fundit e dëboi edhe nga banesa. Në këto kushte J.G. detyrohet të kthehet në Shqipëri, pasi në Greqi nuk kishte ku të jetonte tjetër. Kthimi në Shqipëri e vuri përballë një problematike tjetër po kaq të mprehtë, pasi ajo s’kishte as fëmijë, as të afërm të tjerë dhe as banesë ku të jetonte, apo strehohej për një periudhë kohe. E moshuara paraqitet në Policinë e Fierit dhe kërkon UMM ndaj dhëndrit të saj, cili jetonte në shtetin fqinj.</i></b>	<p>Rasti pasi u referua nga Policia Fier u menaxhua dhe nga koordinatoreja vendore me anëtarë të tjerë të MKR<sup>së</sup>. Pasi u plotësua kërkesë padia për UMM<sup>në</sup>, u kërkuar që viktima të akomodohej në qendrën kombëtare të viktimave të dhunës në Kamëz. Pas lëshimit të UMM<sup>së</sup>, në bashkëpunim me policinë e Fierit, viktima e transportua në qendrën kombëtare të viktimave të dhunës në Kamëz. U sigurua edhe transport për seancën e vërtetimit të UM<sup>së</sup>.</p> <p>Nga ana e koordinatores vendore, u mundësua plotësimi i dokumentacionit të nevojshëm për ta transferuar të moshuarën në qendrën rezidenciale për të moshuar jashtë territorit të Fierit, pasi qendra rezidenciale e Fierit nuk kishte vende të lira për gra. Akomodimi i saj u realizua në bashkëpunim me SHSSH<sup>në</sup> në një qendër tjetër, që kishte kuota të lira.</p> <p>Ende vazhdon mbajtja e kontakteve me institucionet e sipërpërmendura dhe mbikqyrja e rastit.</p>
<b><i>Viktima ishte një zonjë 35 vjeçe nga Nj.A Levan, fshati Levan, e martuar me dy fëmijë</i></b>	<p>Menjëherë pasi rasti iu referua koordinatores vendore Natasha Sallaku, nisi përpjekja për t’i siguruar viktimës strehim dhe punësim. Nga njohjet personale koordinatoreja</p>

<p><b>(15 vjeç dhe 18 vjeç). Bashkëshorti i saj jetonte prej vitesh në emigracion dhe ende nuk kishte siguruar një shtëpi të përbashkët. Mes tyre gjithmonë kishte konflikt dhe një dhunë psikologjike të vazhdueshme. Në këto kushte ajo i drejtohet Drejtorisë së Shërbimit Social, Bashkia Fier, për strehim dhe punësim.</b></p>	<p>i siguron një punë me të ardhura të mjaftueshme. Zonja kishte vetëm arsimin 8 vjeçar dhe për ta përshtatur me kërkesat e tregut të punës, në bashkëpunim me qendrën e formimit profesional iu mundësua një kurs gatimi falas. Zonja përfitoi falas edhe shërbimim ligjor që ofron Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier. Vazhdojnë përpjekjet për ta përfshirë këtë rast edhe në programet sociale të strehimit që Bashkia Fier është duke implementuar.</p>
<p><b>M.M e vitlindjes 1989 nga Nj.A Cakran, fshati Cakran, e pa arsimuar me dy fëmijë dhunohet sistematikisht fizikisht dhe psikologjikisht nga bashkëshorti. Njërin nga fëmijët e kishte të pa regjistruar, për shkak të mungesës së dokumentacionit. Ajo e kishte lindur fëmijën në Greqi dhe nuk kishte mundur të plotësonte në Shqipëri dokumentacionin e nevojshëm.</b></p>	<p>Pas referimit të rastit pranë koordinatores së MKR<sup>së</sup>, Bashkia Fier, në bashkëpunim me institucionet e linjës, viktimës iu mundësua regjistrimi i fëmijës, si dhe përfitimi i ndihmës ekonomike. Viktima mori UM dhe bashkëshorti i saj u largua nga banesa. Pas largimit nga shtëpia i të shoqit, u krye një vlerësim i thelluar nga administratori social i zonës, në mënyrë që të përfshihej në listën e përfituesve edhe të ndihmave ushqimore nga shoqata/organizata të ndryshme vendase apo të huaja. Mbikqyrja edhe për këtë rast vazhdon.</p>

Burimi: Koordinatorja vendore, Bashkia Fier

### ***Të dhëna nga Drejtoria Vendore e Policisë për Bashkinë Fier***

**Drejtoria Vendore e Policisë Qarku Fier** ka në përbërjen e saj 3 komisariate: Komisarati i Policisë Fier, Lushnje e Mallakastër dhe 3 stacione policore: Patos, Roskovec, Divjakë. Të gjitha të dhënat mblidhen e përpunohen në Drejtorinë Vendore të Policisë së Qarkut Fier.

Në Bashkinë Fier për periudhën Janar – Dhjetor 2020 janë regjistruar 233 raste dhune në familje pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, të dhëna që janë përmbledhur dhe marrë nga komisarati qendër pranë kësaj Bashkie. Ndërkohë që u paraqitën nga viktimat e dhunës 162 kërkesë padi për Urdhër Mbrotjtje, nga të cilat 57 raste janë për veprën penale “Dhunë në familje neni 130/a.

Në rastet e kërkesë padive pranë drejtorisë së policisë së kësaj bashkie qartazi pasqyrohen edhe rastet e shkeljes së UM apo UMM nga dhunuesit kundrejt viktimave, specifikisht në 3 raste. Sa i përket numrit të arrestimit të autorëve, dhunues në familje janë gjithsej 31 arrestime, 8 persona të ndaluar, 2 të shpallur në kërkim dhe 2 procedohen në gjendje të lirë. Të dhëna më të hollësishme paraqiten në tabelën e mëposhtme.

**Tabela 2. Dhuna në familje në Drejtorinë Vendore të Bashkisë Fier**

Përshkrimi	Komisariati –Bashkia Fier
<b>Evidentuar 130/a, 321 dhe vepra të tjera penale</b>	<b>233</b>
Të dëmtuar gjithsej	249
Prej tyre gra/vajza	167
KP.U. Mbrojtje	162
Sh.U. Mbrojtjes	3
V. P. Neni 130/a	57
Vrasje raste/viktima	0/0
Arrest. për 130/a	31
Ndaluar për 130/a	8
Gjendje të Lirë për 130/a	2
Në kërkim për 130/a	2
Autorë të vetëvrarë	0

**Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit**

Përsa i përket bashkëpunimit me MKR-në dhe institucionet e tjera ligjzbatuese, nga ana e DVP Fier vlerësohet i mirë. DVP Fier deklaron se është gjithmonë e hapur dhe shumë bashkëpunuese si një prej institucioneve kryesore, pjesë e MKR<sup>së</sup>, por nuk ka mohuar edhe vështirësitë e hasura gjatë vitit 2020, për të cilat është munduar të bëjë më të mirën në drejtim të luftës kundër dhunës në familje.

- Policia i vë theksin nevojës imediate për mbështetje dhe bashkëpunim nga ana e të gjithë institucioneve ligjzbatuese, si dhe bashkëpunim/komunikim/bashkërendim veprimesh permanente me koordinatoren vendore.
- Një sugjerim dhe nevojë në përmirësimin e rezultateve të luftës kundër dhunës në familje dhe me bazë gjinore që del nga ky institucion është edhe shtimi i burimeve njerëzore në qeverisjen vendore që kanë në fokusin e punës së tyre këtë prioritet. Bashkia duhet që të ketë punonjës të tjerë socialë edhe në njësitë administrative, me qëllim që të mund të bashkëpunojnë me policinë për të qenë të pranishëm në plotësimin e Raportit për Vlerësimin e Riskut për çdo rast dhune të evidentuar në zbatim të ligjit për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare.
- Mungesa e një qendre pritëse për viktimat e dhunës në Bashkinë Fier ngelet një problematikë, pasi ka raste që vijnë në orët e vona të mbrëmjes dhe është pak e vështirë të menaxhohet shpejt, ndërkohë viktimës duhet t'i jepet mbrojtje e menjëhershme. Nuk dihet ende me zbatimin e ndryshimeve të reja të ligjit për dhunën në familje sesi do të

procedohet, pasi vështirësia e nxjerrjes së dhunuesit nga banesa do të evidentohet dukshëm.

Në bazë të ndryshimeve që pësoi në muajin Tetor 2020, ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhënie familjare" i ndryshuar, (Nr. 125/2020 „Për disa shtesa dhe ndryshime“)<sup>1</sup>, burrat (dhunuesit) që dhunojnë gratë apo pjesëtarë të tjerë të familjes, do të dëbohen menjëherë nga banesa duke filluar që nga data 18 Nëntor 2020.

Ligji i mëparshëm priste vendimin e gjykatës për të larguar dhunuesin nga banesa, kohë gjatë të cilës dhunuesi, kryesisht burrat, vijonin dhunën. Me ligjin e ri, një burrë që dhunon gruan do të largohet në kohë rekord nga banesa, ndërkohë që dhunuesit i sigurohet një strehë. Ndryshimet ligjore parashikojnë edhe detyrimin e dhunuesve për të marrë pjesë në programe rehabilitimi psikosociale dhe në programe të aftësimin prindëror, të organizuara nga subjekte publike ose private. Ky detyrim do të vendoset nga gjykata në urdhrin e mbrojtjes.

Gjykata, si masë mbrojtëse të dhunës në familje, urdhëron menjëherë largimin e dhunuesit nga banesa për një afat kohor të caktuar, kur viktimat dhe dhunuesi banojnë në të njëjtën strehë. Gjykata, kur është rasti, në vendosjen e kësaj mase merr në konsideratë nevojat e veçanta të dhunuesit të mitur, të moshuar ose personit me aftësi të kufizuara dhe në këto raste urdhri i largimit nga banesa vendoset vetëm kur asnjë masë tjetër nuk garanton mbrojtjen e viktimës nga dhuna.

Duke qenë një kohë e limituar nga ndryshimet që pësoi ligji, zyrtarisht në Fier gjatë vitit 2020 nuk ka nisur zbatimin e tij duke mos shënuar asnjë rast të nxjerrjes nga banesa e dhunuesit, pas ndryshimeve ligjore, por ka patur një rast i një dhunuesi që ka dalë nga shtëpia në mënyrë të vullnetshme pas kërkesës së viktimës në prani të forcave të policisë përpara se kjo të vlerësohej taksativisht nga ligji.

### ***Të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Bashkia Fier***

Përgjegjësitë e gjykatave sipas Ligjit për Dhunën në Familje lidhen me shqyrtimin e kërkesave për UM / UMM<sup>të</sup>. Në gjykatat e shkallës së parë me këto çështje merren përgjithësisht gjyqtarët e Seksionit Familjar.

Për periudhën Janar - Dhjetor 2020 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, janë regjistruar 197 çështje për "Dhuna në familje" neni 130, nga të cilat në 152 raste objekti i dhunës kanë qenë gra, kurse në 45 raste burra.

Janë regjistruar 129 kërkesa për Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtje dhe 68 kërkesa për Urdhër të Mbrojtjes. Nga Gjykata janë pranuar 148 kërkesa, janë rrëzuar 26 prej tyre për arsye të mosplotësimit të kushteve në të cilat bazohet urdhri, kurse 23 çështje janë pushuar.

Në 95 raste i/e dhunuari/a ka qenë i/e papunë, në 30 raste kanë qenë në pension, në 35 raste i/e punësuar në sektorin privat, në 19 raste i/e vetëpunësuar, në 15 raste në sektorin publik dhe në 2 raste nxënëse shkolle.

**Tabela 3. Të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier**

<b>Përshkrimi</b>	<b>Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Bashkia Fier</b>
Regjistruar	127
V. P. Neni 130/a	57
Çështje në gjykim	27
Çështje të përfunduara	30
Të pandehura gra	3
U.M.M.	39
U.M.	127
Të paditura gra	20

### ***Të dhëna nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Bashkia Fier***

Gjatë vitit 2020 (periudha janar – dhjetor 2020) Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier ka regjistruar 84 procedime penale „Dhunë në familje”, neni 130. Rezultojnë që të gjitha procedimet janë kryer nga gra. Nga këto procedime, 40 janë të klasifikuara sipas nenit 130/a/4, kurse 42 janë klasifikuar sipas nenit 130/a/1. Bashkëpunimi i këtij institucioni me Mekanizmin e Kordinuar të Referimit, Bashkia Fier ka qenë relativisht i mirë. Ajo që shihet si problematikë por më shumë si një element që mund të ndihmonte në këtë përpjekje ndaj dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore është shtimi i burimeve njerëzore nga ana e njësisë së qeverisjes vendore. Rritja e numrit të punonjësve socialë/psikologë në mbështetje të MKR<sup>së</sup>, me shtrirje edhe në njësi administrative të bashkisë do të ndihmonte më shumë këtë kauzë.

## **Rezultatet e Monitorimit – Viti 2020**

### ***Objektivi 3.1 Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.***

Mekanizmi i Koordinuar i Referimit kryesisht vendoset pranë Bashkive. Koordinatorja Vendore është hallka kryesore e këtij mekanizmi. Ajo ka funksionin edhe të menaxherit të rastit të dhunës në familje. Ajo koordinon punën e Ekipit Teknik Ndërdisciplinor (ETN) dhe shërben si ndërmjetës për institucionet dhe organizatat që ofrojnë shërbime mbështetëse të specializuara, për të mundësuar kujdes dhe trajnim të menjëhershëm dhe afatgjatë, të ofruar me profesionalizëm dhe në përputhje me të gjitha procedurat dhe standardet e miratuara.

Për ndërgjegjësimin e shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje Bashkia Fier, nëpërmjet MKR ka organizuar një sërë aktivitete ndërgjegjësuese e sensibilizuese. Ka qenë prezent edhe nëpër emisione televizive, media lokale, tryeza të përbashkëta me institucione e organizma të ndryshme lokale e kombëtare, pa harruar edhe shpërndarjen e mesazheve të shumta sensibilizuese nëpërmjet rrjeteve sociale. Praktikë e kthyer tashmë në traditë janë edhe takimet me grupet vulnerable, takime në grupe të vogla për shkak edhe të pandemisë, shpesh herë online. Situata pandemike e ka kufizuar disi aktivitetin e MKR-së, por përsëri puna ka vijuar edhe pse jo me të njëjtin intesitet. Janë mbajtur kontaktet e vazhdueshme me policinë, gjykatën, administratorët socialë, administratorët e rajoneve dhe njësisë administrative, etj.

Gjatë vitit 2020 janë realizuar rreth 10 aktivitete. Ato janë realizuar në bashkëpunim me shoqatat/organizatat e shoqërisë civile, të cilat kanë pasur marrëveshje bashkëpunimi me Bashkinë Fier si: Engim, Refleksione, ADRF, etj.

Duke qenë se fushatat ndërgjegjësuere u mbuluan financiarisht nga OSHC<sup>të</sup> bashkëpunëtore, nuk është shpenzuar asgjë nga buxheti i bashkisë 2020 (fondi i përcaktuar për Shërbimin Social ku përfshihet edhe ky sektor).

Në këto aktivitete ka patur një larmi përfshirje dhe pjesëmarrësish. Target grupet ishin të përziera, duke filluar me komunitetin e papërcaktuar, kalimtarë të rastit, të rinj, pensionistë, media etj. Një tjetër target-grup ishin edhe administratorët socialë, të cilët kanë kontakt të drejtëpërdrejtë me komunitetin, por edhe me viktimat e dhunuesit. Në një prej aktiviteteve, që ishte takim i drejtëpërdrejtë ka patur si target-grup gratë rome, gratë me ndihmë ekonomike dhe disa gra viktime të dhunës në famije, të cilat ndanë eksperiencat e tyre duke shërbyer si raste për të rritur besimin në institucionet vendore/qëndrore.

Anëtarët e MKR, punonjësit socialë dhe psikologët e shkollave, si dhe mjekët e familjes pranë qendrave shëndetësore, kanë qenë vazhdimisht prezent pothuajse në çdo aktivitet me përfshirje. Gjatë vitit 2020 janë realizuar gjithashtu edhe takime informuese për dhunën në familje me gra me aftësi të kufizuara, në bashkëpunim me ADRF.

Gjatë fushatës së 16 ditëve të aktivizimit u realizuan aktivitete në rrugë, një emision në median lokale, si dhe 4 spote me mesazh sensibilizues/ndërgjegjësuere ku u përfshinë: koordinatori vendor, komuniteti fetar, komuniteti Rom, efektivë policie. Këto spote u transmetuan në media dhe rrjete sociale ditët e fundit të fushatës dhe masivisht më 10 Dhjetor, Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut.

Numërohen 7 aktivitete të koordinuara dhe të realizuara nga OSHC<sup>të</sup> në territorin e Bashkisë Fier.

- Takim me administratorët social – 12 pjesëmarrës.
- Takim me gazetarët – 10 gazetarë.
- Takim me gratë rome, gra me ndihmë ekonomike, gra viktime të dhunës në famije – 15 pjesëmarrëse.
- Takim me anëtarët e MKR<sup>së</sup> – 16 pjesëmarrës.
- Takim me punonjës social, psikologë shkollash – 5 pjesëmarrës.
- Takim me gra me AK – 15 pjesëmarrës.

Aktivitetet janë organizuar në bashkëpunim me organizatat ENGIM, ADRF, REFLEKSIONE.

Gjatë vitit 2020, Bashkia Fier ka firmosur 2 (dy) marrëveshje bashkëpunimi me OSHC<sup>të</sup>. Një marrëveshje është firmosur me ADRF dhe tjetra me Shoqatën „Refleksione“. Të dyja këto marrëveshje bashkëpunimi kanë për qëllim bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e MKR-së dhe administratës së shërbimit social në Bashkinë Fier, për pjesëmarrje në takime dhe aktivitete informuese, këshilluese dhe ndërgjegjësuere në luftë kundër dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore.

Ndërkohë, Bashkia Fier ka bashkëpunim të hershëm me organizata ndërkombëtare, si: UNDP dhe UN WOMEN. Bashkëpunimi gjatë vitit 2020 ka konsistuar në organizim seminaresh online, ndihmë me paketa ushqimore, kite higjienike, maska, të cilat janë shpërndarë edhe viktimave të dhunës në familje.

Gjatë vitit 2020 trajnimet kanë qenë të kufizuara për shkak të pandemisë, por janë realizuar trajnime dhe seminare online, në platformën zoom nga shoqata dhe organizata të ndryshme të shoqërisë civile, si dhe nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Gjithashtu janë zhvilluar 3 trajnime të përbashkëta të të gjithë anëtarëve të mekanizmit: një trajnim nga MSHMS; një trajnim në bashkëpunim me ADRF; një trajnim me Shoqatën “Refleksione”. Të gjitha me fokus “Stop dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore”.

Bashkia Fier ka një bashkëpunim shumë të mirë me Kishën Ort’hodokse në Fier, si dhe me Shoqatën Selam, përfaqësues të komunitetit Musliman.



**Tabela 4. Tabela e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore dhe datat e realizimit të tyre**

Nr.	Data	Vendi	Tema	Organizuar nga:
1	20.11.2020	Bashkia Fier	Parandalimi i dhunës, si dhe njohja me shërbimet.	Bashkia Fier Refleksione
2	24.11.2020	Ambjent privat - Fier	Takim me gratë rome – trajtimi i dhunës në familje dhe me bazë gjinore si fenomen, masat ndëshkimore, raste konkretet dhe trajtimin e tyre.	Bashkia Fier Refleksione
3	25.11.2020	Pedonale e qytetit	Dëgjo, Beso, Mbështet  (Dhuna në familje dhe ajo me nazë gjinore)	Bashkia Fier  Engim  Epoka e Re
4.	26.11.2020	Ambjent privat – (local)- Fier	(Roli i Medias në luftën kundër dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore)  <i>Takim me gazetarët e mediave lokale e kombëtare Fier.</i>	Bashkia Fier Refleksione
5	30.11.2020	Tv Kombi	Emision televiziv Për dhunën si fenomen dhe shërbimet e ofruara, përpjekjet e bëra për parandalimin e saj, etj...	Bashkia Fier  Refleksione Policia
6	1.12.2020	Bashkia Fier	(Njohja me ndryshimet e fundit që ka pësuar ligji i dhunës në familje) Takim me Administratorët social	Bashkia Fier

7	10.12.2020	Televizione – Media sociale	Video – spote ndërgjëgjësuese për luftën kundër dhunës në familje dhe me bazë gjinore.	Bashkia Fier Refleksione Policia Fier Kisha Ort’hodokse Fier Komuniteti Rom
8	12.12.2020	Bashkia Fier	Takim i shkurtër informues dhe prezaantues të ndryshimeve të fundit në ligjin e dhunës në familje dhe atë me bazë gjinore me disa nga anëtarët e Këshillit Bashkiak Fier.	Bashkia Fier ADRF
9	15.12.2020	Zoom	Diskutim online me anëtarët e MKR-së Fier për dhunën në familje, për grupet vulnerable, si: PAK, komuniteti Rom, komunitetet LGBTI.	Bashkia Fier ADRF

Burimi: Koordinatorja vendore, Bashkia Fier

**Tabela 5. Tabela e aktiviteteve në bashkëpunim me organizatat me bazë fetare**

Nr.	Data	Vendi	Tema	Organizuar nga:
1	10.12.2020	Televizione – Media sociale	Video – spote ndërgjëgjësuese për luftën kundër dhunës në familje dhe me bazë gjinore.	Bashkia Fier Refleksione Policia Fier Kisha Orthodokse Fier Komuniteti Rom

Burimi: Koordinatorja vendore, Bashkia Fier

**Objektivi 3.2: Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.**

Mekanizmi i Referimit kryesisht vendoset pranë Bashkive. Koordinatorja Vendore është hallka kryesore e këtij mekanizmi. Ajo ka funksionin edhe të menaxherit të rastit të dhunës në familje. Ajo koordinon punën e Ekipit Teknik Ndërdisciplinor (ETN) dhe shërben si ndërmjetës për institucionet dhe organizatat që ofrojnë shërbime mbështetëse të specializuara, për të mundësuar

kujdes dhe trajnim të menjëhershëm dhe afatgjatë, të ofruar me profesionalizëm dhe në përputhje me të gjitha procedurat dhe standardet e miratuara. Për Bashkinë Fier, Koordinatore Vendore e Sektorit të Shërbimit Social, Njësia për BGJ & DHF, NGJ & KV, është Natasha Doko Sollaku (me kohë të plotë).

MKR në Bashkinë Fier është ngritur në vitin 2012, në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit, dhe së fundmi në bazë të Protokollit të Menaxhimit të Rasteve të Dhunës në Familje. MKR Fier bashkëpunon me të gjithë aktorët lokalë. GTN mblidhet pothuajse çdo 3 muaj. Për rastet emergjente thirren aktorët që ofrojnë shërbime. Komunikimet janë periodike dhe bashkëpunimi është i mirë dhe korrekt, kryesisht me aktorët kryesorë.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2020, MKR<sup>ja</sup> ka trajtuar 94 raste, të cilat pothuajse të gjitha kanë një rezultat të kënaqshëm, duke u klasifikuar me zgjidhje të suksesshme. Rastet janë referuar në mënyra të ndryshme. Shumica e rasteve janë referuar nga Policia, SPZ, dhe nga vetë viktimat e dhunës në familje, nga administratorët socialë, Gjykata, nga Qendra Sociale Murialdo, etj.

Nuk mund të kemi një ndarje të rasteve të referuara, pasi MKR<sup>ja</sup> është një mekanizëm që për çdonjërin prej tyre, pavarësisht mënyrës apo polin e referimit, ka rol kyç në veprimet e mëtejshme. Rastet janë trajtuar duke respektuar bazën ligjore, ligjin e dhunës në familje, nr.9669/2018 dhe protokollin e menaxhimit të rasteve të dhunës në familje. Është mbledhur MKR, janë bërë vlerësimet sipas intervistës me viktimën dhe janë ofruar shërbimet përkatëse për të cilat ka pasur nevojë rasti.

Çdo informacion, raportet dhe gjithçka tjetër rreth rasteve ndahen me anëtarët e MKR<sup>së</sup> me email, por edhe fizikisht kur mblidhen gjatë takimit të programuar për të menaxhuar raste të reja.

Rastet që ndiqen dhe menaxhohen nga Bashkia Fier hidhen në sistemin online Revalb sistematikisht. Gjatë vitit 2020 nuk ka patur pothuajse asnjë problematikë, përveç një rasti kur nuk pranohej fjalëkalimi personal, por edhe ky problem u zgjidh pas komunikimit me përgjegjësit e sistemit, të cilët siguruan një passëord të ri. Përsa i përket shpeshësisë së të dhënave që hidhen në sistemin REVALB, ai pasurohet sa herë ka të dhëna të reja.

Koordinatorja vendore Natasha Sollaku, përveç sektorit të dhunës në familje, mbulon edhe çështjet e Barazisë Gjinore. Koordinatorja është punonjëse/Specialist i Nivelit të Lartë (SNL), me status të nëpunësit civil. Ajo ka marrë trajnime të ndryshme gjatë gjithë kohës, edhe gjatë vitit 2020 ku ka funksionuar sistemi online. Sipas saj, *Protokolli i dalë nga MSHMS në muajin Prill është firmosur konform ligjit dhe me Nr. Protokollin përkatës.*

Në buxhetin e Bashkisë Fier nuk ka një zë të veçantë për sektorin e Dhunës në Familje. Koordinatorja është pjesë e organikës së Drejtorisë së Shërbimit Social, në Bashkinë Fier. Buxheti për Drejtorinë e Shërbimit Social ka një vlerë prej 5 mln lekë, ku përfshihen të gjitha shërbimet sociale që ofron Bashkia Fier. Nuk ka një zë specifik vetëm për MKR<sup>në</sup>. Nga ky buxhet mund të përdoret edhe për MKR<sup>në</sup>, në varësi të nevojave/aktiviteteve. Buxheti i bashkisë për pagë të koordinatorit të MKR<sup>së</sup> (pa Materiale dhe Aktivitete) shkon në vlerën 708 000 lekë.

Mbështetje reale për viktimat e dhunës në familje dhe me bazë gjinore është dhe programi i strehimit nëpërmjet bonusit të qirasë, që është në proces implemetimi nga ana e Bashkisë Fier. Viktimat e dhunës në familje kanë prioritet të veçantë në këtë skemë mbështetëse për strehim. Viktimat e dhunës janë informuar nga ana e MKR<sup>-së</sup> për këtë shërbim. Gjatë vitit 2020 është trajtuar vetëm një rast viktime dhune në familje me bonusin e qirasë. Viktima banonte në Fier, por nuk rezultonte me gjendje civile në Fier. Pavarësisht kësaj është mbështetur me bonusin e qirasë. Janë mbështetur gjithashtu me pagesë qiraje nga shoqata “Të Ndryshëm dhe të Barabartë”, 3 viktima të dhunës në familje, si dhe me pagesë të NE<sup>-së</sup>, të gjitha viktimat që kanë përfituar UM.

Një institucion i rëndësishëm i zinxhirit të trajtimit të këtyre rasteve është dhe Shërbimi i Provës. Misioni parësor i Shërbimit të Provës është mbrojtja e komunitetit dhe parandalimi i përsëritjes së veprës penale, asistimi dhe konsultimi për riintegrimin dhe risocializimin me sukses në komunitet të shkelësve të ligjit, duke e ndihmuar nëpërmjet metodave dhe instrumenteve më bashkëkohore, në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin shoqëror dhe sjelljen e ndryshimeve pozitive në jetën e tyre. <sup>2</sup>

Për përmbushjen e misionit, Shërbimi i Provës, bashkëpunon me institucione shtetërore, qëndrore apo lokale, me komunitetin lokal, institucione të tjera dhe organizata jofitimprurëse për zbatimin e dënimeve alternative. Stafi angazhohet në përgatitjen e raporteve të vlerësimit para dhe pas gjykimit duke vlerësuar prejardhjen shoqërore, kushtet familjare dhe planet konkrete për ri-integrim shoqëror si dhe realizon mbikëqyrjen e të dënuarve me dënime alternative me qëllim mbrojtjen e interesave publike dhe parandalimin e kryerjes së veprave penale. Ky shërbim kryen kontroll mbi të dënuarit dhe vepron si mburojë për komunitetin.

Nga njëra anë u jep mundësinë autorëve të veprave penale të cilët kanë mundësi për ri-integrim dhe rehabilitim në shoqëri të rifillojnë më shpejt jetën në komunitet ndërsa nga ana tjetër kontrollon dhe ndëshkon autorët e veprave penale duke vepruar si mburojë për komunitetin.

Sigurisht për të arritur rezultate të kënaqshme vepohet në bashkëpunim me shërbimet lokale sociale dhe të mirëqenies për të nxitur dhe rritur mundësitë e përfshirjes në shoqëri.

Bashkëpunimi me të gjithë anëtarët e MKR<sup>-së</sup> ka qenë i mirë dhe korrekt. Vijon e njëjta praktikë si vitet e kaluara. Këtë e vërtetojnë dokumentacionet përkatëse, proces – verbalet, ftesat, emaillet etj.

Plotësimi i UM<sup>-së</sup>/UMM<sup>-së</sup> bëhet në varësi të drejtimit që merr viktimat për të kryer denoncimin. Pjesa më e madhe e UMM<sup>-ve</sup> dhe e UM<sup>-ve</sup> plotësohen në SPZ<sup>-të</sup>, por edhe nga koordinatori vendor. Për vitin 2020 numri i UM<sup>-ve</sup> i plotësuar nga koordinatori vendor është pak më i ulët krahasuar me vitet e kaluara, për shkak të situatës pandemike. Për vitin 2020 janë plotësuar rreth 23 UM dhe UMM.

Për akomodim në Strehëzën Kombëtare është referuar vetëm një rast gjatë vitit 2020. Një e moshuar, e cila dhunohej nga dhëndri. Ajo jetonte në shtëpinë e tij dhe të vajzës së saj. Nuk kishte

të afërm të tjerë dhe nuk kishte asnjë strehë. Në këto kushte, viktimat u akomodua në Strehëzën Kombëtare. Rasti po procedohet për ta akomoduar në shtëpinë e të moshuarve.

Përgjatë vitit 2020 janë mbajtur dhe organizuar 4 mbledhje të drejtëpërdrejta të GTN<sup>së</sup> në zyrën e koordinatores vendore dhe 1 online në platformën ZOOM. Për të vërtetuar bashkëpunimet e mësipërme për rastet e dhunës në familje janë procesverbalët, të cilat i disponon koordinatori i Mekanizmit të Referimit pranë Bashkisë Fier.

Për periudhën Janar – Dhjetor 2020, KD nuk arriti të mblidhej.

**Tabela 6. Numri i mbledhjeve të GTN-së ne vitin 2020 në Bashkinë Fier**

Data	Mbledhjet e GTN-së
	<b>Përshkrimi i mbledhjes.</b>
<b>27.05.2020</b>	<i>Gjatë mbledhjes janë diskutuar raste konkrete me anëtarët e MKR-së. Janë ofruar dhe shërbime konkrete në varësi të nevojave që kanë pasur rastet. Shërbimet konsistojnë në: referimin pranë shërbimit ligjor falas, përfaqësim dhe shoqërim të viktimës, ndihma ushqimore dhe kite higjienike, referim pranë psikologut të qendrës komunitare që mbështetet nga psikologu i QS Murialdo, sqarim dhe lehtësim i nxjerrjes së dokumentacionit, etj.</i>
<b>16.07.2020</b>	<i>Mbledhjet janë kryer sipas Protokollit të menaxhimit të rasteve të dhunës. Janë diskutuar rastet, janë bërë vlerësimet sipas nevojave dhe janë ofruar shërbimet e nevojshme e konkrete.</i>
<b>05.10.2020</b>	<i>Mbledhjet janë kryer sipas Protokollit të menaxhimit të rasteve të dhunës. Janë diskutuar rastet, janë bërë vlerësimet sipas nevojave dhe janë ofruar shërbimet e nevojshme e konkrete.</i>
<b>27.10.2020</b>	<i>Mbledhjet janë kryer sipas Protokollit të menaxhimit të rasteve të dhunës. Janë diskutuar rastet, janë bërë vlerësimet sipas nevojave dhe janë ofruar shërbimet e nevojshme e konkrete.</i>
<b>15.10.2020</b>	<i>Takimi u zhvillua online, në platformën Zoom. U diskutua për dhunën në familje si fenomen, për menaxhimin e rasteve emergjente dhe jo emergjente. U diskutuan gjithashtu edhe rastet konkrete që MKR<sup>ja</sup> ka trajtuar dhe menaxhuar për viktimat të dhunës në familje, të cilat i përkasin grupeve vulnerabel, si: PAK, komuniteti Rom, etj...</i>

Burimi: Bashkia Fier

**Tabela 7. Përbërja e Komitetit Drejtues, Bashkia Fier Viti 2020**

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2020
<b>Bashkia</b>	Kryetar, Armando Subashi
<b>Drejtoria e Policisë</b>	Bledar Celiku
<b>Gjykata e Rrethit Gjyqësor</b>	Matilda Shalla

<b>Prokuroria e Rrethit</b>	Violeta Shkurtia
<b>Drejtoria Arsimore Rajonale</b>	Brunilda Dhamo
<b>Drejtoria e Shëndetit Publik</b>	Mirela Mitri
<b>Drejtoria e Shërbimit Social</b>	Mirela Pitushi
<b>Zyra e Përmbarimit</b>	Julian Hoxhaj
<b>Prefektura</b>	Baki Bala
<b>Zyra e Punësimit</b>	Nustret Avdulaj
<b>OSHC/QS Murialdo</b>	Giovanni Salustri
<b>Dhoma e Avokatisë</b>	Zenun Hadërmataj
<b>Shërbimi Shëndetësor</b>	Nevila Shuke
<b>Kisha Ort'hodokse Shqiptare</b>	Mitropoliti i Apollonisë dhe Fierit, Hirësia e tij Imzot Nikolla

Burimi: Bashkia Fier

**Tabela 1. Përbërja e GTN-së, Bashkia Fier Viti 2020**

<b>Institucioni</b>	<b>Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2020V</b>
<b>Bashkia</b>	Natasha Sollaku
<b>Drejtoria e Policisë</b>	Enkeleda Allkanjari
<b>Gjykata e Rrethit Gjyqësor</b>	Elvira Tartaraj
<b>Prokuroria e Rrethit</b>	Eni Begaj
<b>Drejtoria Arsimore Rajonale</b>	Mimoza Niko
<b>Drejtoria e Shëndetit Publik</b>	Irma Papingu
<b>Zyra e Përmbarimit</b>	Arjan Çepele
<b>Prefektura</b>	Arben Velo
<b>Kryetarët e Njësive</b>	NjA.R.1. – Maksim Zarka

<b>Administrative</b>	NjA.R.2. – Eduart Sollaku NjA.R.3. – Astrit Mukaj NjA.4. – Ermelinda Çepele NjA.Qendër – Fatbardha Prifti NjA.Dërmënas – Dilaver Shyti NjA.Topojë – Aleksandër Kola NjA. Mbrostar – Mustafa Hebeja NjA.Portëz – Pandeli Bozha NjA.Levan – Ahmet Bahaj NjA.Frakull – Dashnor Troka NjA. Cakran – Tonin Xhelaj NjA.Libofshë – Themie Doko
<b>Zyra e Punësimit</b>	Merita Pove
<b>Organizata Jo qeveritare</b>	Elvi Daka
<b>Strehëzat për viktimat e dhunës</b>	-
<b>Komunitete fetare</b>	Ingrida Bida, Kastriot Dyrmishaj
<b>Dhoma e Avokatisë së Rrethit</b>	Inva Malaj

Burimi: Bashkia Fier

**Objektivi 3.3: Ndëshkimi i dhunuesve dhe dhënia e mundësisë për rehabilitimin e tyre, përmes programeve të specializuara.**

#### **Urdhërat e lëshuar nga gjykata për dhunuesit;**

Për periudhën janar - dhjetor 2020 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, janë regjistruar 197 çështje për veprën penale "Dhuna në familje" neni 130.

- Vihet re se 99 prej tyre rezultojnë të jenë shënuar nga shtetas me banim në zona rurale (fshat), 85 në qytet dhe 13 në zonat periferike të qytetit. Nga statistikat e marra nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier vihet re gjithashtu se grupmosha mbi 55 vjec numëron 54 raste të dhunës së regjistruar, pasuar nga grupmosha 26 – 35 vjec me 49 raste, më

pas grupmosha 46 – 55 vjec me 39 raste, 36 – 45 vjec me 36 raste, 19 – 25 vjec me 16 raste, 0 -15 vjec me 2 raste dhe 16 – 18 vjec me 1 rast.

- Në 152 raste kanë qenë denoncuese gra dhe në 45 raste kanë qenë burra.
- Në 82 raste lidhja me dhunuesin/en ka qenë bashkëshorti/e; në 62 raste lidhje të tjera; në 25 raste kanë qenë fëmijët dhunues ndaj prindërve, në 12 raste prindi dhunues ndaj fëmijës, në 14 raste vëllai dhunues ndaj vëllait/motrës dhe 2 raste dhunuese motra ndaj motrës/vëllait.
- Përsa i përket nivelit arsimor rezulton se 93 raste dhuna është shënuar në ambient me nivel arsimor 9 vjecar, 55 me arsim të mesëm, 23 me arsim fillor, 19 me arsim të lartë dhe 7 raste pa arsim fare.
- Gjatë periudhës janar – dhjetor 2020 janë regjistruar 197 kërkesa për Urdhër Mbrojtjeje nga të cilat 148 janë pranuar, 27 janë hedhur poshtë dhe 22 janë pushuar.

### **Urdhërat e ekzekutuar nga Zyra e Përmbartimit për dhunuesit**

Për periudhën Janar - Dhjetor 2020, nga Zyra e Përmbartimit Fier ka ekzekutuar 18 tituj ekzekutivë Urdhër Mbrojtje për veprën penale neni 130/a, nga të cilat 16 kanë qenë për dhunën e burrit ndaj gruas dhe 2 kanë qenë për dhunën e fëmijëve ndaj prindërve.

Nga ana e Zyrës së Përmbartimit Fier mësohet se, bashkëpunimi me institucionet e qeverisjes vendore dhe DVPF<sup>së</sup> ka qenë shumë i mirë, falë të cilit nuk janë hasur probleme gjatë ekzekutimit. Problem i madh gjatë ekzekutimit të vendimeve qëndron akomodimi i shpejtë i dhunuesit. Në momentin kur dhunuesi është i detyruar të largohet nga banesa është e vështirë gjetja në një kohë të shkurtër por dhe mungesa e infrastrukturës për të siguruar strehimin e tij.

Ky është një problem i mprehtë që duhet zgjidhur sa më shpejt, pasi zgjidhja e tij shman problemet e dhunës në familje.

Shërbimi i Provës Fier ka aplikuar 28 shërbime alternative për dhunuesit si: pastrim të ambienteve publike (rrugë), shërbim në azile etj. Rasti i një të mituri, i vetëm për vitin 2020 u trajtua tek qendra “Horizont” (qendra e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara), ndërsa për gratë dhe burrat dhunues përdoren të njëjtat trajtime si me të dënuarit e tjerë.

### ***Për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2020, nga ana e DTSHP Fier janë kryer:***

- 6 (gjashtë) urdhëra ekzekutimi për të rritur dënuar sipas veprës penale të parashikuar nga neni 130/a/1 i K. Penal nga të cilët 1 (një) grua.
- 7 (shtatë) urdhëra ekzekutimi për të rritur dënuar sipas veprës penale të parashikuar nga neni 130/a/4 i K. Penal nga të cilët 1 (një) grua.
- 1 (një) urdhër ekzekutimi për të mitur dënuar sipas veprës penale të parashikuar nga neni 130/a/1 i K. Penal.
- 2 (dy) kërkesa për Raporte Vlerësimi për të Miturit, akuzuar sipas nenit 130/a/1, nga prokuroritë.
- 8 (tetë) kërkesa për Raporte në Fazë Hetimi akuzuar sipas nenit 130/a//1 dhe 4 (katër) kërkesa për Raporte në Fazë Hetimi akuzuar sipas nenit 130/a/4 dërguar nga Prokuroria Fier.

Përsa i përket trajtimit të shkelësve të ligjit, Shërbimi i provës për të miturit bashkëpunon aktualisht me qendrën “Horizont”. Gjatë vitit 2019 është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi midis Bashkisë Fier dhe Ministrisë së Drejtësisë për të përdorur qendrën



multifunkionale “Horizont” për të miturit në konflikt me ligjin, (marrëveshje që është në fuqi edhe gjatë vitit 2020) ku Shërbimi i Provës është pjesë e rëndësishme e kësaj marrëveshjeje. Për gratë dhe burrat dhunues përdoren të njëjtat trajtime si me të dënuarit e për vepra penale të tjera.

Shërbimi i Provës bashkëpunon me institucione dhe OJF<sup>ve</sup> të ndryshme në bazë të memorandumeve të bashkëpunimit për referimin e rasteve sipas specifikës së tyre. Ndërkohë vazhdon që prej vitit të kaluar (2019) bashkëpunimi me Qendrën Sociale “Murialdo” (sipas një marrëveshjeje bashkëpunimi të firmosur dhe dakordësuar me këtë qendër). Duke pasur parasysh faktin se të miturit shkelës së ligjit, vijnë kryesisht nga familje me probleme social-ekonomik, një suport për ta ka qenë marrja e arsimit profesional falas, mundësuar nga QSM<sup>ja</sup>.

Gjatë vitit 2020 Shërbimi i Provës Fier ka pranuar ftesën për bashkëpunim me OJF<sup>në</sup> “ENGIM” me qendër në Itali dhe me aktivitet të shtrirë edhe në Shqipëri, Fier. Duke qenë se kjo organizatë ka si qëllim (nëpërmjet projektit që po zbaton) fuqizimin e sistemit të orientimit, formimit dhe rikualifikimit profesional, me anë të stazheve e dhënies së bursave për fillimin e sipërmarrjeve të vogla për shtresat në nevojë apo në konflikt me ligjin është një fushë e mirë bashkëpunimi edhe me Shërbimin e Provës. Ky bashkëpunim do të fokusohet në dhënien e bursave për gratë e dënuara ose të miturit në konflikt me ligjin, për të zhvilluar kurse profesionale në pasticerinë sociale “Che Buono”, administruar nga ENGIM. Ky bashkëpunim pritet të shtrihet edhe në një gamë më të madhe kursesh profesionale, me qasje sa më pranë kërkesave të tregut.

Hallkat më të dobëta të MKR<sup>së</sup> vazhdojnë të rezultojnë Gjykata, Prokuroria dhe Përmbarimi. Sipas ligjit, kur një UM ose UMM vjen nga Gjykata, ai duhet të ekzekutohet menjëherë nga Përmbarimi, por duke mos patur dosjet e veta për rastin ky i fundit nuk vepron nëse viktimja e dhunës nuk shkon të regjistrohet vetë atje. Mosprezenca e viktimës, që ndodh rëndom, e pengon ekzekutimin e vendimit.

### **Konkluzione të rëndësishme**

Mekanizmi i Referimit pranë bashkisë Fier ka një bashkëpunim të mirë me anëtarë, por shihet një apati në mbledhjen e KD<sup>së</sup>, për të cilën ndoshta ka ndikuar dhe situata pandemike. Kjo situatë ka bërë që edhe ndikimi i koordinatores së MKR<sup>së</sup> në asistimin gjatë plotësimit të UM<sup>ve</sup> dhe UMM<sup>ve</sup> gjatë vitit 2020 të jetë më i ulët se vitet e mëparshme.

Ajo që mbetet ende një problematikë e pazgjidhshme është mungesa e programeve për rehabilitimin e dhunuesve. Në Bashkinë Fier ende nuk ka programe të specializuara për rehabilitimin e dhunuesve dhe për dhënien e mundësive për ta. Mungesë kjo, që e bën edhe më të vështirë përmbushjen e këtij objekti. Në territorin e kësaj bashkie nuk ka as organizata të shoqërisë civile që mund ta ofrojnë këtë shërbim.

Në këtë pikë, për Bashkinë Fier mbetet i papërmbushur objekti 3.3, për sa i përket dhënies së mundësisë për rehabilitimin e dhunuesve përmes programeve të specializuara, pavarësisht përpjekjeve të Shërbimit të Provës dhe bashkëpunimeve me OSHC<sup>të</sup> dhe institucione të tjera.

Nga disa prej aktorëve të mekanizmit si, Drejtoria Rajonale Arsimore, Spitali Rajonal Fier dhe Drejtoria e Shëndetit Publik, nuk raportohet që të jenë referues të ndonjë rasti të dhunës në familjare dhe me bazë gjinore. Si pjesë e mekanizmit të referimit, këta aktorë qëndrojnë në hije kur bëhet fjalë për aktivizimin bazuar në të dhëna statistikore. Duke sjellë në vëmendje që në çdo rast të kallëzimeve penale për dhunën në familje viktimja e ka pasur të domosdoshëm paraqitjen para mjekut ligjor rezulton se, Spitali Rajonal Fier nuk disponon një databazë të dhënash për rastet e evidentuara apo shërbimet e ofruara viktimave të dhunës në familje.

Ajo që vazhdon të paraqitet ende si problematikë për Zyrën e Përmbartimit Fier, është fakti që Gjykata nuk i përcjell drejtpërdrejtë këto vendime për ekzekutim në Zyrën e Përmbartimit. Këto vendime duhet t'i paraqesë personalisht kreditori (me kërkesë të palës kreditore), që përkon me viktimën e dhunës në marrëdhëniet familjare. Problem i madh gjatë ekzekutimit të vendimeve qëndron akomodimi i shpejtë i dhunuesit. Në momentin kur dhunuesi është i detyruar të largohet nga banesa është e vështirë gjetja në një kohë të shkurtër por dhe mungesa e infrastrukturës për të siguruar strehimin e tij. Ky është një problem i mprehtë që duhet zgjidhur sa më shpejt, pasi zgjidhja e tij shmang problemet e dhunës në familje.

### Rekomandime kryesore

Në bazë të monitorimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore në bashkinë e Fierit për vitin 2020, më poshtë renditen disa rekomandime të cilat kërkojnë masa të menjëherëshme për të rregulluar funksionimin e Mekanizmit të Referimit kundër Dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Fier dhe adresimin e objektivit të tretë të SKBGJ<sup>së</sup> kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje:

- Ngritja e qendrave të rehabilitimit dhe strehëzave për viktimat e dhunës, një kërkesë kjo e vazhdueshme që ende nuk ka gjetur rrugën e zgjidhjes.
- Ngritja e një qendre pritëse për viktimat e dhunës në Bashkinë Fier. Ka raste që vijnë (kryesisht në polici) në orët e vona të mbrëmjes dhe është pak e vështirë të menaxhohet shpejt, ndërkohë viktimës duhet t'i jepet mbrojtje e menjëherëshme. Nevojë emergjente, pasi me zbatimin e ndryshimeve të reja të ligjit për dhunën në familje nuk dihet ende se si do të procedohet dhe menaxhohet situata pas nxjerrjes së dhunuesit nga banesa.
- Buxhet të dedikuar fushatave ndërgjegjësuese, informuese dhe lobuese në luftë kundër dhunës në familje dhe me bazë gjinore, duke e ndarë atë nga buxheti i Shërbimit Social të Bashkisë.
- Ndryshimi i procedurave institucionale të dërgimit të vendimit/dosjes për ekzekutim nga Gjytata në Zyrën e Përmbartimit, pa detyrimin e pranisë së kreditorit, viktimës.
- Programe të specializuara për rehabilitimin e dhunuesve.
- Mbështetje dhe bashkëpunim më i ngushtë nga ana e të gjithë institucioneve ligjzbatuese, si dhe bashkëpunim/komunikim/bashkërendim veprimesh permanente me koordinatoren vendore, ku të gjithë aktorët e mekanizmit të luajnë rolin e tyre.
- Shtimi i burimeve njerëzore në qeverisjen vendore, që kanë në fokusin e punës së tyre këtë prioritet. Bashkia duhet që të ketë punonjës socialë të tjerë edhe në Njësitë Administrative, me qëllim bashkëpunimin me Policinë për të qenë të pranishëm në plotësimin e Raportit për Vlerësimin e Risikut për çdo rast dhune të evidentuar në zbatim të ligjit për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare.
- Përfshirje më aktive e rolit të koordinatores së MKR<sup>së</sup> në trajtimin e rasteve, me qëllim që të mos mbetet vetëm me mbledhjet dhe shpërndarjen e raporteve periodike, por të ketë dhe një databazë për nevojat dhe shërbimet që ka/merr viktimat e dhunës.
- Ndërtimi i një databazë të veçantë për mekanizmin e referimit për të shpërndarë informacionet e nevojshme për dhunën në familje dhe me bazë gjinore, mënyrat e trajtimit, adresat e shërbimeve, mënyrën e riintegrit të viktimës së dhunës në shoqëri etj.
- Zgjidhje sa më e shpejtë e akomodimit të dhunuesve për të shmangur problemet e dhunës në familje.